

GJYKATA THEMELORE,DEPARTAMENTI I PERGJITHSHEM-DIVIZIONI PER KUNDERVAJTJE NE FERIZAJ,sipas gjyqtares Nazife Beqiri, me Sekretaren juridike Fatmire Mani, duke vendosur në proceduren kundërvajtëse kundër të pandehurit Rafiz Sejdiu nga fsh. Doganaj, komuna Ferizaj, për shkak të kundërvajtjes nga neni 5,6 paragrafi 1.3 dhe neni 9 të Ligjit për Deklarimin e Prejardhjes dhe Kontrollit të Pasurisë së zyrtarëve të lartë public dhe deklarimin e prejardhjes dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë (Ligji nr.04/L-050), e në bazë të nenit 73, 74, 195 dhe nenit 199 të Ligjit Mbi Kundërvajtjet (ligj I aplikueshëm), më datën 31.08.2013 solli:

A K T V E N D I M

Ipandehuri Rafiz Kadri Sejdiu , I lindur më 05.09.1950 në fshatin Greme, me vendbanim në fshatin Doganaj komuna e Ferizajt, I martuar, babe i 6 femijëve, Inxhinier i makinerisë, anëtar I Asamblesë Komunale të Ferizajt, I gjendjes mesme ekonomike, Shqiptar, shtetas I Republikës së Kosovës,

E s h t ë P ë r g j e g j ë s

Sepse, si anetar I Asamblesë së Komunës së Ferizajt, nuk ka vepruar sipas kerkeses se Agjencionit Kosovar Kunder Korrupsionit te dt.01.03.2012,pasi sipas Ligjit mbi Deklarimin e Prejardhjes dhe Kontrollin e Pasurise se zyrtareve te lartë publik dhe deklarimin e prejardhjes dhe kontrollin e dhuratave per te gjithë personat Zyrtare (Ligji nr.04/L-050), nuk e ka plotesuar formularin e ketij Agjencionit dhe nuk e ka deklaruar pasurine,

-me qka ka kryer kundervajtjen nga neni 17 par.1.3 lidhur me nenin 5al.1 te Ligjit per Deklarimin mbi Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurise dhe Dhuratave te Zyrtareve te larte Publik,

Andaj, ne baze te nenit 17 par.1.3 lidhur me nenin 5 al.1 te Ligjit mbi Deklarimin e Prejardhjes dhe Kontrollin e Pasurise dhe Dhuratave te Zyrtareve te larte Publik (Ligji nr.04/L-050)e ne veshtrim te nenit 9 te LK

D E N O H E T

ME DENIM ME GJOBE ne shume prej 500.00 E (Pesqind Euro)

Denimin e shqiptuar ne te holla I pandehuri obligohet ta paguajë ne afat prej 15 ditesh, nga dita e plotfuqishmerise se ketij aktvendimi, e nese nuk e paguan ne afatin e lejuar ligjor, e njejta do t'i shndërrohet ne denim me burg ne kohezgjatje prej tridhjetë (30) ditesh.

Ne emer te shpenzimeve te procedures kundervajtese I pandehuri obligohet te paguaj Shumen paushall prej 5 E, ne te njejtin afat sikurse denimin, nen kercenim te permbarimit te detyrueshem.

A r s y e t i m

Agjencioni Kosovar Kunder Korrupsionit ne Prishtine, ka parashtruar kerkesen nr.01-2222/12 te dt.04.06.2012 per fillimin e procedures kundervajtese ndaj Rafiz Sejdiut nga fshati Doganaj, komuna e Ferizajt, per shkak te kundervajtjes nga neni 5,6 par 1.3 te Ligjit mbi Deklarimin e Prejardhjes dhe Kontrollin e Pasurise se zyrtareve te larte public dhe deklarimin mbi prejardhjen dhe kontrollin e Dhuratave per te gjithë personat Zyrtare dhe ka propozuar qe I njejti te shpallet pergjegjes dhe te denohet sipas ligjit.

Gjyqtari e udhehoqi proceduren kundervajtëse dhe e degjoi te pandehurin I cili ne mbrojtjen e

REPUBLIKA E KOSOVES		AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT	
AGJENCIA PËR TËR KOSOVËN		AGJENCIA PËR TËR KOSOVËN	
Dep.	DPK/DMP	Nr. Prot.	03-2932/13
Dep.		Datim	23.09.2013
Nr. I taq.			
Broj. stranica	03		
Nr. pagese			

03-2932/13/02
Sey

vet dhene para kesaj gjykate me dt.26.09.2012 ka mohuar kundervajtjen qe I vihet ne barre dhe ka theksuar se nuk ka qenë në dijëni dhe nuk ka patur kerkesë e as formular per deklarim te pasurisë dhe theksoi se nuk e ka sqaruar zyrtari kontaktues I Komunes se Ferizajt se eshte I obliguar ta beje nje gje te tillë dhe se ka menduar qe formularin per deklarim te pasurise qe e ka plotesuar kur janë zgjedhur keshilltarë te Asamblesë Komunale, vlen gjate gjithë mandatit sa jane keshilltarë, por pranoi se atyre-asambleistëve ne menyre te pergjithsuar u eshte thene nga shperndaresi I KK Ferizaj qe ai qe nuk I ka plotesuar formularet duhet me I plotesu .

Per vertetimin e gjendjes faktike gjyqtarja ftoi deshmitarin Naser Musa, zyrtar I pikes kontaktuese te Komunes se Ferizajt I cili ka theksuar se materialet bashk me formularet qe I ka pranuar nga AKK ju kan shperndare te gjithe keshilltareve te Komunes duke ua lene ne tavoline ne mbledhjen e dt.09.03.2012, e poashtu kan qene te njoftuar edhe gojarishte (se duhet te plotesohen formularet) nga kryesuesi Agim Aliu(tash kryetar I Komunes se Ferizajt) dhe prezentoi ne Gjykate regjistrin e pjestareve pjesmarres ne ate mbledhje, ku gjyqtarja vertetoi faktin se I pandehuri Rafiz Sejdiu ka qene prezent ne ate mbledhje dhe ka nenshkruar ate regjister.

Nderkaq deshmitari tjetër Afrim Matoshi, zyrtar per mbarvajtje te KK Ferizaj theksoi se ju ka shpernda keshilltarve formularet per deklarimin e pasurise(pasi te njejtit I ka marre nga Naser Musa) duke ia lene secillit keshilltare ne ulese, e qe bashke me formularet kane patur edhe nje rekomandim per plotesimin e te njejteve.

Ne cilesin e deshmitarit u ftua edhe perfaqesuesi I AKK Enis Sadiku, I cile ne deklaraten e tij nder tjera theksoi se me hyrjen e ligjit te ri ne fuqi per deklarimin, prejardhjen e pasurise 04/L-050 kane per obligim qe edhe keshilltaret komunal ta bejne deklarimin e pasurise, ne pastaj nga pikat kontaktuese kemi kerkuar te na dergojne listen e zyrtarve te larte qe kane per obligim deklarimin e pasurise nga K Ferizaj(meqe email adresa te secilit keshilltar nuk kemi) e ne mesin e tyre ka qene edhe Rafiz Sejdiu I cili nuk ka bere deklarimin e pasurise dhe ndaj tij kemi inicuar rast per mos deklarim te pasurise sipas kerkeses se AKK-së

Gjyqtarja vleresori provat veq e veq dhe te gjitha se bashku, dhe konstatoi se edhe pse I pandehuri mohon kundervajtjen me te cilen ngarkohet ai prapseprap deshmon se ka qene I njoftuar per obligimin e deklarimit te pasurise kur thot se neve na eshte thene ne menyre te pergjithsuar se duhet me I plotesu formularet dhe thenia e tij se ka menduar se deklarimi I pasurise ne kohen kur jane zgjedhur keshilltarë komunal vlen deri ne fund te mandatit, poashtu deklaratat e deshmitareve dhe shkresat e lendes jane fakte bindese se I pandehuri ka kryer vepren me te cilen ngarkohet per qka u shpall pergjegjes dhe u denua me gjobë si ne dispozitiv te ketij aktvendimi

Gjate matjes se denimit eshte marre parasysh pasha e kundervajtjes dhe pasojat e saja, rrethanat nen te cilat eshte kryer kundervajtja (nga pakujdesia), se nuk jane shkaktuar pasoja te renda, se eshte hera e pare qe I pandehuri ka kryer kundervajtje. Gjyqtarja vendosi ta beje zbutjen e denimit nen minimumin ligjor konform nenit 9 al1 pika 1 te LK, duke marre perbaze edhe dispozitat e nenit 7 te LK-së, duke llogaritur se edhe me kete gjobe do te arrihet qellimi I ndeshkimit, ashtu qe I pandehuri ne te ardhmen te mos kryejë vepra te tilla apo te ngjashme

Nga sa u tha me larte u vendos si ne dispozitiv te ketij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE, DEPARTAMENTI I PERGJITHSHEM – DIVIZIONI PER KUNDERVAJTJE NE FERIZAJ

Sekretarja juridike

Fatmire Mani



03-2932/13/03
Skup

KESHILLA JURIDIKE:

Kunder ketij aktvendimi te pandehurit dhe parashtresit

**Te kerkeses iu lejohet ankesa ne Gjykatën e Apelit – Divizioni per Kundervajtje
ne Prishtine, ne afat prej 8 ditesh, pas marrjes se ketij aktvendimi,
permes kesaj Gjykate**